# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-449471**

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Urime Albin Kurti… Por, historia nuk mund të apelohet! |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/blogu-tema/urime-albin-kurti-por-historia-nuk-mund-te-apelohet-i586508` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 16 shtator 2026, 14:15:03 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 16 shtator 2026, 14:10:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `cbd22dfbe359b5a0f6c77f52ec1248f98bf295e88fd61ce2a2876838d37474db` |
| TEKSTI | `f20a5abdcb89392104abdb081f0ccdc40e3f4f1d961750688472143f825244a1` |
| PAMJA | `2939104a86744a70e679dddf5ec71d7d8d38c00997619388fd1507e386a8ed14` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `bfbe4f9cafb7a81a0c8df6584004076ae95c9507dfa6004b700552a80e546ca4` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `485c8b8c8ba28305218c58e8c7791d525f1a193166e89422b0670a53018cd566` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/bfbe4f9cafb7a81a0c8df6584004076ae95c9507dfa6004b700552a80e546ca4`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Urime Albin Kurti… Por, historia nuk mund të apelohet!

TemA

16 Shtator 2026, 16:10Blog Nga Martin Leka

Sot, në ditën kur Haga dha vendimin ndaj katër prej figurave kryesore të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Kosova përjeton një nga ditët më të rënda të saj politike dhe emocionale.

81 vite burg për katër prej drejtuesve të UÇK-së. Vendimi i shkallës së parë i shpalli fajtorë për disa krime lufte, ndërsa i shpalli të pafajshëm për akuzat për krime kundër njerëzimit.

Dhe ndërsa në Kosovë qytetarët e kanë përjetuar rëndë e me dhimbje këtë vendim, një pyetje mbetet e pashmangshme: çfarë mesazhi duhet të japë sot udhëheqja politike e Kosovës?

Për Kosovën kjo ditë nuk mund të jetë thjesht një aktgjykim juridik.

Është edhe një moment politik, historik dhe kombëtar, ku nuk duhet heshtje politike, nuk duhet kalkulim, nuk duhet kujdes elektoral dhe nuk ka nevojë për kujtesë selektive.

Albin Kurti vetëm pas tre orësh ju drejtua popullit tè Kosoves, ndërkohë që nuk kishte mbetur njeri politik në hapësirën shqiptare pa thënë fjalën e vet.

Edhe kur foli, ai nuk tha asgjë se cdo të bëhet me një gjykatë që flet e merr vendime në emër të popullit të Kosovës, të popullit të Albinit që ka mbushur sheshet e Kosovës kundër këtij vendimi.

Albin Kurti ka qenë për vite një kundërshtar politik i shumë prej figurave që sot ndodhen në Hagë. Kjo është pjesë e historisë politike të Kosovës.

Sepse kur historia vihet në diskutim, institucionet e Kosovës nuk mund të komunikojnë sikur po zhvillohet një ditë e zakonshme politike.

As fakti që vendimi do të apelohet, nuk mund të bëjë asnjë shqiptar të presë.

Ajo që nuk mund të apelohet është historia. E Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. E Popullit të Kosovës,

Zhvillimet politike në Kosovë tregojnë se sa i rëndësishëm është pushteti për Albin Kurtin

Ndaj "urime" Albin (edhe Vjosa). Sipas Hagës, edhe 25 vjet, kundërshtarin nuk e ke përballë!

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Disa sugjerime për leximin e aktgjykimit ndaj katër ish-drejtuesve të lartë të UÇK-së

15:54 Blog

## Hashim, sot po të shkruaj si mik

15:05 Blog / 4 komente

[Si mund të përfundojnë në dënime të ngjashme dy anë të kundërta të historisë?]

14:45 Blog / 1 koment

[Drejtësi apo turp? Shqiptarët janë dënuar për luftën me 150 vite burgim më shumë se serbët]

14:20 Blog / 8 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.